



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
  - \* Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
- \* Aktivitetet për për profesionet e tjera ligjore
  - \* Aktivitetet tjera

Tetor 2019

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Zbatimi i udhëzuesit për politikat ndëshkimore

Më 1 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e trajnimit me temën “Zbatimi i udhëzuesit për politikat ndëshkimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në zbatimin e drejtë në praktikë të udhëzuesit ngase do të ketë ndikim pozitiv që politika ndëshkimore të bëhet me unifikuese në të gjitha gjykatat.

Me rastin e këtij trajnimi u vu në pah se në praktikë me rastin e shqiptimit të dënimeve vërehet se është bërë vlerësim joadekuat i rrethanave dhe po ashtu nuk ka arsyetim të mjaftueshëm të këtyre rrethanave. Vëmendje gjatë trajnimit iu kushtua, rrethanave lehtësuese dhe rënduese karakteristikë e te cilave është se nuk janë shteruese pra, mund të merren edhe rrethana tjera. Rrethanat rënduese janë të prira për të qenë më specifike dhe të qarta sesa

rrethanat lehtësuese, kurse është në pajtim me konceptin e pranuar se rrethanat të cilat e ashpësojnë dënimin duhet të jenë të sakta, të qarta dhe të mund të provohen. I pandehuri dhe publiku e kanë të qartë se çfarë veprimesh do të rezultojnë në dënim më të ashpër.

Gjatë këtij trajnimi u vu në pah se zbatimi i Udhëzuesit për politikat ndëshkimore është një mundësi e mirë e cila shmang jo konsistencën në dënime prej një gjykate në gjykatën tjetër dhe kryerësve të veprave penale të natyrës së njëjte t’iu shqiptohen dënime të përafërta dhe me këtë edhe unifikim të politikës ndëshkimore.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunor profesional të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës.



## Zgjidhja alternative e kontesteve me theks të veçantë ndërmjetësimi- civile

Më 03 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e GIZ-it organizoj trajnimin me temë: “Zgjidhja alternative e kontesteve, me theks të veçantë ndërmjetësimi - civile” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me mënyrat e zgjidhjes alternative të kontesteve, me theks të veçantë ndërmjetësimi – aspekti civil.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Roli dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve lidhur me referimin e rasteve në ndërmjetësim dhe rëndësia e përgjegjësia që ka ndërmjetësuesi në raport me palët e përfshira në kontest gjatë mbajtjes së seancës të ndërmjetësimit. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan Marrëveshjet për ndërmjetësim dhe përmbarimi i marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit.

Në trajnim u theksua se aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve, veçanërisht ndërmjetësimi është i një rëndësie të veçantë, pasi që rritë sigurinë juridike dhe mundëson tërheqjen e investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin ekonomik, sepse në botën bashkëkohore të afarizmit, bizneset dhe qytetarët, janë të interesuar për t'i zgjidhur kontestet e tyre jashtë procedurave gjyqësore.

Më tej u potencua se Republika e Kosovës në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson zgjidhjen alternative të kontesteve. Konkretisht ndërmjetësimi në Kosovë është

rregulluar me Ligjin - Nr.03/L-057 (2008) e i shfuqizuar me Ligjin- Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim - Gz. Z. Nr.14 (2018). Ndërsa zbatimi në praktikë ka filluar në vitin 2012 kur janë licencuar ndërmjetësuesit e parë dhe janë hapur Qendrat e Ndërmjetësimit në disa qytete të Kosovës.

Në aspektin ndërkombëtar ndërmjetësimi është rregulluar me Ligjin Model apo UNCITRALIN, pastaj me Direktivën 2008/52/EC, e cila direktivë i ka obliguar shtetet anëtare të BE-së që të rregullojnë me ligje të veçanta çështjen e ndërmjetësimit dhe kjo flet për rëndësinë e këtij instrumenti.

Gjithashtu u potencua se gjyqtarët e Kosovës duhet të njohin rregullat e reja kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërmjetësim, përparësitë që ka, pasojat ligjore të tij, pastaj rolin e tyre në referimin e rasteve në qendrat e ndërmjetësimit dhe pozitën e ndërmjetësuesve.

Në vazhdim u theksua se numri i madh i mosmarrëveshjeve, ka ndikuar që zgjidhja e tyre përmes rrugës gjyqësore të vështirësohet, dhe të marr kohë, krejt kjo qoftë për shkak të pamundësisë së gjykatave ta përballojnë fluksin e madh të këtyre lëndëve si dhe për shkak të mungesës kadrovike e disa faktorëve të tjerë. Në vazhdimësi është hulumtuar që të gjenden zgjidhje efikase për mosmarrëveshjet në mes të palëve të ndryshme dhe njëra nga këto alternativa është ndërmjetësimi që tani njihet në botën demokratike dhe zbatohet në pjesën dërmuese të shteteve.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatave Themelore përkatësisht të divizionit civil, bashkëpunëtorët profesional dhe ndërmjetësuesit.

## Burgu për të mitur

Më 8 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-seë ka realizuar trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë me temë: “Burgu për të mitur”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit me burg për të mitur.

që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën kapacitetet profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim të shqiptimit të dënimit me burg për të mitur

Me rastin e trajnimit u diskutuan kushtet për shqiptimin e dënimit me burgim për të mitur, që kanë për qëllim rehabilitimin dhe zhvillimin e të miturit me anë të edukimit, zhvillimit të aftësive profesionale, zhvillimit të tij personal dhe

ndikimit pozitiv në të me qëllim të parandalimit që ai sërish të kryej vepër penale.

Gjatë trajnimit u vu në pah që Kodi i Drejtësisë për të Mitur garanton interesin më të lartë të drejtësisë për të miturit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilat rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Paraprakisht vëmendje gjatë trajnimit iu kushtua edhe trajtimit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit me burgim për të mitur si dhe praktikave më të mira me rastin e shqiptimit të kësaj mase.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë për të mitur të nivelit themelor si dhe bashkëpunëtor profesional.



## Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Më 10 Tetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin me temë “Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjatë trajnimit është trajtuar e drejta e privatësisë dhe legjislacioni që e garanton këtë të drejtë, procesi i mbrojtjes së të dhënave personale, përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, vëzhgimi me kamerë të cilat janë përpunim i të dhënave personale të cilat aplikohet në sektorë publik por edhe privat, ku si

qëllim është të sigurohet jeta e njerëzve, siguria e pronës publike apo private po ashtu edhe ruajtjen e dokumentacionit në mënyrë kofidenciale.

Në kuadër të këtij trajnimi po ashtu është trajtuar: mbrojtja e të dhënave në kontekst të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe të KEDNJ-së, mbrojtja administrative e të dhënave personale, mbrojtja gjyqësore e të drejtave personale.

Trajnimi është realizuar përmes prezantimit të përmbajtjes së temave duke u shoqëruar me pyetje dhe diskutim interaktiv në mes të pjesëmarrësve dhe trajnuesve të angazhuar.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët e çështjeve administrative të nivelit të Apelit, duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor nga kjo gjykatë si dhe gjyqtar nga divizioni penal nga niveli themelor si dhe prokuror dhe bashkëpunëtor profesional nga Prokuroria Themelore e Prishtinës.



## Shkëputja e kontratës dhe efektet e shkëputjes

Më 15 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin me temë “Shkëputja e kontratës dhe efektet e shkëputjes ekonomike”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me shkëputjen e kontratës dhe efektet e shkëputjes së saj.

Në fokus të trajnimit ishte kontrata dhe objekt i kontratës, elementet e kontratës, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, llojet e kontratave, oferta, mënyra e ofertimit si dhe kushtet e ofertës. Po ashtu, janë trajtuar edhe kontratat absolutisht të pavlefshme si kontrata të cilat janë të lidhura në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperative dhe moralin, ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes të kontratave të pavlefshme, efektit juridik të kontratave nule, si dhe të drejtës së kërkesës për

vërtetimin e pavlefshmërisë.

Në vazhdim është diskutuar edhe për shkëputjen si një mënyrë për të përfunduar kontratën, zgjidhja e kontratës - heqja dorë nga kontrata në mënyrë të njëanshme, mos përbushja e kontratës dhe pasojat juridike të shkëputjes, kushtet për shkëputje dhe dështimi për të përbushur detyrimet, përfundimi i kontratës si kusht për të pushuar kontrata si dhe efekti juridike i përfundimit të kontratës.

Trajnimi është zhvilluar në forme të bashkëbisedimit aktiv me pjesëmarrësit lidhur me dilemat që hasin gjatë punës praktike. Vlen të theksohet se trajnimi është shoqëruar me raste hipotetike pas trajtimit të secilës pjesë të agjendës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarët e nivelit themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovës si dhe bashkëpunëtorët profesional.



## Trajnimi lidhur me aftësitë ligjore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Me 15-18 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSBE-në ka realizuar një trajnim lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përkatësisht për Konventën Evropiane me theks të veçantë për nenin 5, 6 si dhe nenin 1 protokollit nr. 1 të kësaj konvente.



Me rastin e këtij trajnimi për një fjalë rasti iu drejtuan Kryesuesi i KGJK-së, z. Skender Çoçaj, kryetar i Gjykatës Supreme z. Enver Peci, si dhe z. Ilia Bundaleski, Drejtor i Qendrës Rajonale në Mitrovicë, Misioni i OSBE-së Të gjithë njëzëri në fjalët e tyre e konfirmuan domosdoshmërinë e trajtimit të kësaj materie me qëllim të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procedurave ligjore duke potencuar edhe garantimin e tyre edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.



Në ditën e parë dhe të dytë të këtij trajnimi u trajtuan neni 5 i cili ka të bëjë me të drejtën e lirisë dhe sigurisë si dhe neni 6 i kësaj konvente i cili ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë. Me rastin e trajtimit të këtyre neneve u përdoren raste të ndryshme të studimit përmes të cilave u ofruan zgjidhjet më të mira duke marrë për bazë legjislacionin vendos si dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në dy ditët e fundit është trajtuar neni 1 i protokollit nr. 1 për të drejtën e pronësisë e cila po ashtu është elaboruar përmes rasteve praktike.

Me rastin e këtij trajnimi, Akademia e Drejtësisë për gjyqtarët dhe prokurorët e regjionit të Mitrovicës shpërndau Doracakun për të Drejtat e Njeriut dhe Fjalorin juridik, publikime këto që Akademia e ka botuar së fundmi për ti kontribuar zbatimit të drejtë të nocioneve dhe praktikave gjyqësore më të mira në procesin e bërjes së drejtësisë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët e regjionit të Mitrovicës.



## Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike sipas LPK-së

Më 17 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas LPK-së” në kuadër të PTV-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurën e paraqitjes së mjeteve juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nga ana e palëve të autorizuar, si dhe vendosjen e gjykatave të instancave më të larta rreth këtyre mjeteve.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Procedura e vendosjes me ankesë, procedura e vendosjes sipas revizionit dhe procedura e vendosjes sipas propozimit për përsëritje të procedurës. Në pjesën e dytë u trajtuan: Raporti në mes revizionit dhe propozimit për përsëritjen e procedurës dhe Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe procedura e vendosjes.

Në fillim të trajnimit u potencua se me rastin e vendimmarrjes nga ana e gjykatave të instancës më të ulët, jo rrallë ndodhë që të bëhen gabime në aspektin formal dhe material, të cilat mund të kenë ndikim në garantimin e ligjshëm të të drejtave të palëve në procedurën kontestimore. Andaj, përmes shfrytëzimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, palët mund t’i atakojnë këto vendime dhe të kërkojnë respektimin e kërkesave dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në këtë procedurë.

Duke analizuar të drejtën e goditjes së vendimeve u potencua se ajo është një e drejtë elementare e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës por edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore. E drejta në ankesë ndaj një vendimi gjyqësor është edhe standard i së drejtës ndërkombëtare të drejtave të njeriut, e jo thjeshtë vetëm një e

drejtë që buron nga legjislacioni i brendshëm i një shteti.

Në vazhdim u theksua se përmes mjeteve juridike të goditjes garantohet zbatimi i parimit që çdo çështje të shqyrtohet të paktën në dy instanca gjyqësore dhe shqyrtimi në instancën e shkallës së dytë bëhet përmes ushtrimit të mjetit të goditjes-ankesës. Sa i përket gjerësisë së rishikimit që duhet të bëhet nga gjykata më e lartë, është standard themelor që rishikimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë të përfshijë si kontrollin e të drejtave procedurale ashtu edhe kontrollin e meritës së rastit, duke mundësuar që një gjykatë më e lartë të bëjë rishikimin si formal ashtu edhe substancial të rastit të gjykuar në shkallë të parë.

Më tej u zbërthyen çështjet dhe pyetjet se: Çka duhet të përmbajnë mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike? Cilat janë shkaqet më të shpeshta për paraqitjen e tyre? Cila është procedura e pranimin dhe shqyrtimit të këtyre mjeteve? dhe cilat janë vendimet që mund t’i nxjerrin gjykatat, lidhur me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike?

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve nga praktika e pasur gjyqësore duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi si dhe duke sqaruar paqartësitë e përmendura më lartë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, të Gjykatës së Apelit (Divizioni Civil) dhe bashkëpunëtorët profesional.



## Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror

Më 22-23 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror” në kuadër të PTV-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve në tematikën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, adoptimi, dhe vendosja e fëmijës në familjen tjetër. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Kujdestaria; ushtrimi, pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi i të drejtës prindërore dhe mënyrat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore.

Në trajnim u theksua se Republika e Kosovës është një nga shtetet e cila është e angazhuar seriozisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Meqenëse mbrojtja juridike e familjes në përgjithësi, e posaçërisht e fëmijëve në veçanti ka rëndësi të veçantë, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita të cilat i referohen sferës familjare, përmes të cilave e rendit shtetin tonë në grupin e vendeve me rregullativën juridike familjare të harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar. Në Kushtetutë është përfshirë edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës e cila zbatohet drejtpërdrejtë dhe ka prioritet.

Në këtë trajnim ndër të tjera u trajtuan edhe çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve (adoptimi, kujdestaria, etj.), të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen, duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Gjithashtu diskutimet u përqëndruan rreth mënyrës dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët

në procedurë gjyqësore, rreth parimit të interesit më të lartë të fëmijës, rolit të gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe legjislacionit të zbatueshëm vendor dhe atij ndërkombëtarë.

Në vazhdim u potencua se parimi i interesit më të lartë të fëmijës mbështetet në Konventën për të drejtat e fëmijës e cila normon se: “Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”. Ky parim është inkorporuar edhe në legjislacionin vendor dhe atë në Ligjin për Familjen dhe në Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer standardet ndërkombëtare dhe vendimet e GJEDNJ dhe kërkesat e dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin: gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjykatave themelore-Departamentit të Përgjithshëm-Divizionet Civile, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

## Zbatimi i ligjit për Regjistrimin Civil (regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi)

Më 23 Tetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) në bashkëpunim me UNHCR dhe CRPK ka realizuar trajnime me temë “Zbatimi i ligjit për Regjistrimin Civil (regjistrat e gjendjes civile, regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi)”.

Qëllimi i realizimit të këtij trajnime ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me organizimin e gjendjes civile në Kosovë dhe etapat e zhvillimit të saj si dhe zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit mbi Gjendjen Civile. Në kuadër të këtij trajnime janë trajtuar dispozitat ligjore për regjistrat e gjendjes civile në Republikën e Kosovës, regjistrat e gjendjes civi-

le – korigjimi dhe plotësimi në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile, Regjistrimi i lindjes në bazë të dokumenteve bazë të lindjes, Regjistrimi i mëvonshëm dhe ri-regjistrimi.

Trajnime është realizuar në forme të debatit interaktiv ku janë përfshirë të gjithë pjesëmarrësit. Dilemat e parashtuara në këtë trajni janë eliminuar me përgjigjet e trajnuesve të angazhuar qoftë nga praktika gjyqësore qoftë nga ekspert te UNHCR dhe CRPK.

Përfitues të këtij trajnime ishin: bashkëpunëtorë profesional, zyrtar ligjorë nga gjykata dhe prokuroria si dhe zyrtarë nga UNHCR dhe CRPK.



## Program i specializuar – Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër Korrupsionit

Më 24-25 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temën “Program i specializuar – Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër Korrupsionit, sesi III.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore në rastet e veprave penale që janë të ndërlidhura me korrupsionin.

Me rastin e këtij trajnimi u elaboruan veprat penale që janë të ndërlidhura me korrupsionin duke vënë në pah kuptimin e korrupsionit sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e korrupsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe

koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit. Po ashtu gjate trajnimit u elaboruan instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftë kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës si dhe bashkëpunëtor profesional.



**Trajnimi në vendin e punës për prokurorët, që shërbejnë si pikë kontaktuese për BJK dhe për Koordinatorin për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtarë në Kryeprokurorin e Shtetit si autoritet i ndërmjetëm**

Më 25 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e GIZ, ka realizuar trajnimin me temë: “ Trajnimi në vendin e punës për prokurorët, që shërbejnë si pikë kontaktuese për BJK dhe për Koordinatorin për bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtarë në Kryeprokurorin e Shtetit si autoritet i ndërmjetëm ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe funksionalizimi i pikave kontaktuese në hetimin, grumbullim e provave, ekstradim dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë. Ky trajnim trajtoj rolin dhe detyrat e prokurorit si pikë kontaktuese për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar.

Po ashtu u prezantua roli dhe detyrat e prokurorit në autoritetin e ndërmjetëm si koordinator

për pikat kontaktuese të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, bashkëpunimi në mes të pikave kontaktuese për ndihmën e ndërsjellë juridike në prokuroritë themelore dhe koordinatorin për BJK në Kryeprokurorin e Shtetit si autoritet i ndërmjetëm. Vëmendje iu kushtua shqyrtimit paraprak të kërkesave të brendshme nga pikat kontaktuese, shqyrtimi formal nga koordinatori, fushëveprimi i shqyrtimit formal/vendimet dhe propozimet e arsyeshme për grupet e rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zëvendës kryeprokurorja e shtetit, kryeprokuror, prokuror nga prokuroria speciale si dhe prokuror nga niveli themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Sekuestrimi dhe konfiskimi

Më 29 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me projektin Mbështetje e mëtejshme institucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm B&S, realizuan trajnimin me temë “Sekuestrimi dhe konfiskimi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve me dispozitat Ligjore lidhur me Ligjin e ri për Kompetencat e zgjeruara të Ligjit për Konfiskim dhe Sekuestrim (LKZK).

Gjatë këtij trajnimi nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar u trajtuan institutet e reja të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskim, përputhshmëria dhe kontinuiteti i dispozitave të sekuestrimit dhe konfiskimit në ligjet bazike si KPRK dhe KPPK me LKZK-në, dallimet mes KLZK-së vjetër dhe LKZK-së së re, përputhshmëria e instituteve të reja të LKZK-së

me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ-së.

Vëmendje iu kushtua masave që mund të propozohen për sigurimin e pasurisë dhe cilat janë masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se është përdorur në veprën penale nën hetim, është provë e veprës penale nën hetim, ose është fituar nga vepra penale nën hetim. Paraprakisht përmes shembujve u analizuan metodat për identifikimin e aseteve dhe procesi i sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve të fituara me vepër penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë dhe staf i administrativ nga gjykatat dhe prokuroritë nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Trafikimi me qenie njerëzore

Më 30-31 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Organizatës Evropiane për Ligjin Publik ELPO, mbajti punëtorinë dy-ditore me temë: “Lufta kundër Trafikimit me qenie njerëzore”

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të pjesëmarrësve në zbatim të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe përforcimi i bashkëpunimit mes institucioneve tjera relevante për luftimin e suksesshëm të kësaj dukurie.

Gjatë kësaj punëtorie janë trajtuar aspektet ligjore të Trafikimit me qenie Njerëzore, të kuptuarit e viktimës si dhe perspektivat e viktimës. Me fokus të veçantë ishte mbrojtja e viktimës para dhe gjatë zhvillimit të procesit

penal, mbështetja, rehabilitimi i viktimës dhe riintegrimi i saj në shoqëri. Me rastin e kësaj punëtorie përmes rasteve praktike u vu në pah se trafikimi me qenie njerëzore është dukuri e përhapur dhe më fitimprurëse e krimit të organizuar, duke arritur dimensione të njëjta me trafikimin e drogës dhe të armëve. Andaj, u kërkua që pjesëmarrësit të kuptojnë drejt elementet e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të njohin format e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me njerëz në mënyrë që të ketë rezultate në luftimin e këtyre veprave.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarët, prokurorët dhe stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial nga gjitha regjionet e Kosovës.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Komponenta e trajnimit teorik për këtë periudhë, është përmbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: gjithsejtë 18 sesione trajnuese janë realizuar nga modulet: “Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinore”, “Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar”, “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese” dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës.



Në kuadër të nën modulit “Etika profesionale” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese përkatësisht janë shtjelluar: Rregullorja për përcaktimin e sjelljeve të pahijshme, bashkëpunimi dhe koordinimi i gjykatave me institucionet tjera për raste të ndjeshme dhe detyrat dhe funksionet e Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD).

Nga nën-moduli “KEDNJ” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese, synimi i të cilave qëndron tek zgjerimi i njohurive të gjyqtarëve të sapo emëruar lidhur me Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut të nenit 13 dhe nenit 14.

Gjatë muajit tetor nga nën moduli “Ndërmjetësimi” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ndër të cilat u trajtuan: Ndërmjetësimi në çështjet penale dhe rëndësia e ndërmjetësimit si dhe ndërmjetësimi në çështje civile.

Në këtë periudhë gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar trajnimin nga nën moduli “E drejta e BE-së” katër (4) sesione trajnuese, ku temë

diskutimi kanë qenë: Struktura e Traktateve, natyra e kompetencave dhe parimet themelore të së Drejtës së Bashkimit Evropian si dhe Institucionet dhe burimet e së Drejtës së Bashkimit Evropian.

Gjithashtu nga nën-moduli “Krimet e rënda” është realizuar një sesion trajnues ku gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja rreth trafikimit me qenie njerëzore, pastrimi parave dhe krimet kibernetike. Ndërsa, nga nën moduli “Kodi i drejtësisë për të mitur” gjatë muajit tetor janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku janë trajtuar: përkufizimet që përdoren në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe shqiptimi i masave dhe dënimeve madhorëve për veprat penale të kryera si të mitur.

Po ashtu nga nën moduli “Arsyetimi i vendimeve gjyqësore” është realizuar një (1) sesion trajnues ku gjyqtarët patën rastin të njoftohen lidhur me rëndësinë e shkrimit ligjor. Në kuadër të trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar trajnimi përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykatat përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program. Gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit tetor po ashtu kanë realizuar trajnimin praktik në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe në Agjencinë shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilët kanë pasur mundësi të diskutojnë për rolin, strukturën dhe problemet e shfaqura në praktikë.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 39 gjyqtarë të sapoemëruar, ku shtatë prej tyre janë nga komuniteti serb.

## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VIII)

Akademia e Drejtësisë, në përmbushje të programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar.

Gjatë muajit tetor, në kuadër të trajnimit teorik për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar (18) sesione trajnuese nga moduli “Kodi i Procedurës Penale” dhe “Kodi Penal i Republikës së Kosovës”.

Nga nën moduli “Aktakuza procedura e shqyrtimit” është realizuar një (1) sesion trajnues, ku prokurorët kanë pasur mundësi të thellojnë njohuritë e tyre rreth sfidave të prokurorit të shtetit në aspektin e ekspertimit mjeko ligjor me rastin e ngritjes së aktakuzës, si dhe prokurorit të shtetit përballë autopsisë mjeko ligjore. Gjithashtu nga nën modulit “Shmangia dhe ndjekja” është realizuar një (1) sesion trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të avancojnë njohuritë lidhur me Shmangia nga ndjekja penale sipas KPPK-së dhe pezullimi i hetimit sipas KPPK-së.

Po ashtu prokurorët kanë realizuar dy (2) sesione nga nën moduli “Administrimi i procedurës penale” dhe janë shtjelluar: Parashtrësat, afatet si dhe marrja dhe komunikimi i vendimeve, dërgimi i shkresave, ekzekutimi i vendimeve dhe dispozitat tjera dhe shkresat që duhet dorëzuar personalisht si dhe procedura e dorëzimit.

Në kuadër të nën modulit “Veprat penale të korrupsionit” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku janë trajtuar: Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare nga neni 414-420 të KPRK-së.

Nga nën moduli “Provat në procedurën penale” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese, ku prokurorët kanë pasur mundësi të diskutojnë në përgjithësi për provat, sigurimin dhe provat në fazën e hetimeve të provave.

Ndërsa në kuadër të nën modulit: Kallëzimi penal janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese, ku prokurorët kanë pasur rastin të zgjerojnë njohuritë lidhur me kallëzimin penal, kallëzimi penal i policisë si dhe të dhënat plotësuese.

Po ashtu, në drejtim të përmbushjes së programit praktik trajnues, prokurorët e sapo emëruar kanë vijuar trajnim edhe në Agjencinë e Privatizimit në Kosovë, Doganën e Kosovë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës si dhe në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përmes të cilave patën rastin të përfitojnë njohuri lidhur me punët të cilët i zhvillojnë këto institucione.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (10) ditë trajnimi praktikë në prokurorit përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar.





## Trajnim praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Më 09 Tetor 2019, në kuadër të trajnimit praktik me institucionet jo gjyqësore gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar të cilët janë duke vijuar trajnimin fillestar, kanë realizuar një trajnim në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi me zhvillimet dhe funksionet e privatizimit të subjekteve të AKP-së, rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit, ku me theks të veçantë u trajtuan edhe verifikimi dhe shpallja e fituesit të përkohshëm, aprovimi dhe refuzimi i ofertës, dhe informata të përgjithshme për procesin e privatizimit dhe likuidimit në Kosovë.

Gjithashtu gjatë trajnimit, janë trajtuar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme problemet

aktuale në praktikë, duke njohur dhe kuptuar më mirë rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit në Kosovë dhe zbatimin e drejtë të procedurave për privatizimin e subjekteve.

Trajnimi u zhvillua edhe në formë interaktive, me ç'rast gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar kishin mundësinë të diskutojnë çështje me interes me të cilat ata mund të ballafaqohen në praktikën e tyre me lëndët e kësaj natyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VII-të dhe prokurorët e sapoemëruar, gjenerata e VIII e PTF-së.



## Vizitë e prokurorëve të sapo emëruar në Institucionin Doganor të Kosovës

Më 16 Tetor 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, ka realizuar një vizitë/trajnim në Doganën e Kosovës.



Qëllimi i kësaj vizite/trajnimi qëndron tek njoftimi i prokurorëve të sapo emëruar me rolin, misionin, punën, strukturën dhe aktivitetet të cilat i kryen Dogana e Kosovës.

Në kuadër të agjendës së kësaj vizite/trajnimi ishin temat që lidhen drejtpërdrejt me luftimin e aktiviteve ilegale, krimin kufitar, luftimi i

trafikimit të drogës, si dhe parandalimi kontrabandimit të armëve nukleare dhe substancave eksplozive.

Po ashtu gjatë trajnimit u shtjelluan edhe temat të ndryshme të cilat janë në interes të prokurorëve të sapo emëruar. Në veçanti u diskutua për taksën doganore, tatimin mbi vlerën e shtuar, akcizën për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, kontrollimi i importit dhe eksportit, mbroja e ekonomisë dhe mbrojtja e markave tregtare.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç'rast prokurorët e sapo emëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VIII të PTF-së.



## Vizitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës

Më 23 tetor 2019, në kuadër të programit trajnues për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar vizitën e radhës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar lidhur me veprimtaritë dhe strukturën ligjore të funksionimit të këtij institucioni.

Gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar patën mundësi të informohen rreth regjistrimit të parcelave, ndërtesave, objekteve afariste, dhënien e lejeve për banim, identifikimin e objekteve të banimit dhe vendosjen e tyre në harta topografike, punët gjeodezike, si dhe matjet shtetërore. Po ashtu u njoftuan edhe me sistemin e ri për marrjen e certifikatës e ashtuquajtur “E-Kiosku”.

Me fokus të veçantë u trajtua tema e pronave dhe parcelave me numër të madh të paregjistruara, mos respektimi i barazisë gjinore në regjistrimin e pronave dhe sistemin horizontal të organizimit.

Gjatë trajnimit gjyqtarët dhe prokurorët sapo emëruar, patën mundësin bashkërisht me zyrtarët nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, të diskutojnë për çështjet e interesit të përbashkët, me qëllim të bashkëpunimit reciprok në të ardhmen.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII) dhe prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VIII) 2019-2020.



## Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

### Prezantimi i platformës së mësimit në distancë, bibliotekës ligjore elektronike të AD-së

Më 4, 11, 25 dhe 31 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSBE-në ka realizuar 4 punëtori regjionale me temë: “Prezantimi i platformës së mësimit përmes internetit, bibliotekës ligjore elektronike të AD-së.”

Qëllimi i këtyre punëtorive ishte njoftimi nga afër me shërbimet e teknologjisë informative që ofron Akademia e Drejtësisë për përfituesit e saj si: web-faqja e AD-së, aplikimi online për trajnime, funksionimi i platformës së mësimit në distancë, kyqja në platformë, aplikimi për kurse trajnuese, ndjekja e trajnimeve përmes platformës, kyqja në bibliotekën elektronike të

Akademisë, gjetja e literaturës në këtë bibliotekë, dhe literatura që posedon biblioteka fizike e Akademisë.

Me rastin e kësaj punëtorie është demonstruar praktikisht nga pjesëmarrësit qasja në platformat dhe data bazat që ofron Akademia në mënyrë që të ardhmen të jenë shfrytëzues të burimeve dhe materialeve ligjore që ofrojnë këto platforma.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, zyrtarë të IT-së, nga Gjykatat Themelore dhe Prokuroritë Themelore në Prishtinë, Prizren dhe Gjilan.



## Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore

### Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën gjyqësore

Më 25 Tetor 2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it , ka realizuar trajnimin me temë: “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të fëmijëve në aspektin civil, dhe në kontestet martesore-familjare.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan temat: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë proce-

durës së shkurorëzimit, parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas LFK, kujdesi prindërorë, vendimi i gjykatës për ushtrimin e kujdesit prindërorë .

Gjatë trajnimit u diskutuan edhe raste nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas lidhur me çështjet problematike të kësaj natyre.

Me fokus të veçantë u shtejlluan edhe çështjet mbi besimin e kujdesit të fëmijës personit të tretë si dhe roli i organit të kujdestarisë në procedurën e besimit të fëmijës.



## Aktgjykimet dhe llojet e aktgjykimit sipas dispozitave të LPK dhe Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provave

Më 26 Tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të aktiviteteve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin me temë: “Aktgjykimet dhe llojet e aktgjyqimeve sipas LPK dhe Shqyrtimi kryesor



dhe marrja e provave”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore për udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësorë nga ana e zyrtarëve të ndihmës

juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi janë trajtuar çështjet si në vijim: Llojet e aktgjyqimeve dhe kushtet për nxjerrjen e tyre, përmbajtja e aktgjykimit dhe arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit si dhe identifikimi i rasteve të marrjes së provës gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Gjithashtu përgjatë trajnimit janë diskutuar raste nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas me ç ‘rast janë trajtuar temat me theks të veçantë të kësaj natyre, si: Vlerësimi, hartimi dhe arsyetimi i drejtë i llojeve të aktgjyqimeve si formë e vendosjes meritore, si dhe shqyrtimi i provave .

Përfitues në këtë trajnim ishin 13 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regionet



## Aktivitetet tjera

### Konferenca rajonale: "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë – Faza e dytë"

Me 9 tetor 2019, Këshilli i Evropës në Shkup realizoi konferencën rajonale të "Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë – Faza e dytë" në kuadër të mekanizmit të koordinimit të ekspertizës.

Qëllimi i kësaj konference ishte që të mbështet rezultatet e fazës së parë, për të ndihmuar bashkëpunimin teknik përshtatur sipas vendit për arritjen e një përmbushjeje më të madhe të standardeve evropiane, duke ofruar këshillime dhe ekspertizë si përgjigjeje ndaj kërkesave për analiza dhe asistencë përmes mekanizmit të koordinimit të ekspertizës.

Gjatë kësaj konference u të trajtu-

an çështjet nga garantimi i drejtësisë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me theks të veçantë transparenca e gjyqësorit në raport me qytetarët.

Vëmendje të veçantë gjatë kësaj konference iu kushtua luftës kundër krimit ekonomik, anti diskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të cenuara. Paraprakisht liria e shprehjes dhe e medias si dhe barazia gjinore ishin objekt trajtimi dhe diskutimi i kësaj konference.

Në këtë konferencë morën pjesë pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe, Turqia.



## Trajnimi i trajnuesve për menaxhimin e gjykatave

Më 15-16 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e USAID-it organizoj trajnimin me temë: “Menaxhimi i gjykatave”. Ligjërues në këtë trajnim ishte - z. Ingo Keilitz, ekspert nga USAID-i.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të udhëheqësve në gjykata në lëmin e menaxhimit.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan: Menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë, tiparet e një menaxheri të mirë, detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe tiparet menaxhuese dhe tendencat që duhet shmangur. Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan: Matja e angazhimit të punëtorëve, interpretimi i të dhënave për angazhimin e punëtorëve të gjykatës dhe kërkimi i pikave të ndritshme.

Në vazhdim u potencua se me këtë trajnim synohet ngritja e kapaciteteve profesionale për pjesëmarrësit në sferën e menaxhimit i cili ngërthen organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim.

Pas një shqyrtimi të gjithanshëm u ofruan përgjigje në çështjet: Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë apo prokurori? Cilat janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Dhe cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës dhe prokurorisë?

Në këtë trajnim u potencua se organizimi i një analize është hapi i parë më i rëndësishëm drejt reformimit. Vula e një sistemi drejtësie me performansë të lartë është vullneti politik dhe kapaciteti në performansë në baza të rregullta dhe të vazhdueshme, për të përfutur njohuri dhe depërtim në realitete të reja, mundësi dhe nevoja, dhe për të kthyer njohurinë dhe këtë

depërtim në strategji efektive për përmirësim.

Në vazhdim u veqta rekomandimi se “për ta matur të rëndësishmen” dhe “për të llogaritur të llogaritshmen” duke shpjeguar se ky shpreh parimin thelbësor i cili, në mënyrë që të jetë efikas, masat e performansës dhe treguesit duhet të rreshtohen me vlerat, obligimet themelore dhe faktorët kyç të suksesit të një institucioni publik. Këto të fundit në mënyrë tipike shprehen përmes deklaratës së qëllimit, vizionit dhe qëllimeve strategjike, të cilat, në kthim reflektojnë obligime të gjëra qeveritare të shprehura në ligjin për politikën publike. Fokusi duhet të jetë në rezultatet dhe arritjet, dhe jo detyrimisht në format (burimet dhe strukturat) apo në funksionet (veprimtaritë).



Ky trajnim ofroi edhe shpjegime që kanë të bëjnë me menaxhimin e gjykatave dhe prokurorisë përmes kombinimit të prezantimeve ku u trajtuan strategjitë e avancuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të gjykatave dhe prokurorisë. Gjatë tërë procesit u zhvillua një qasje pragmatike e implementimit të rregullave për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv.

Përfutur në këtë trajnim ishin kryetarët e gjykatave, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve.



## Menaxhimi i gjykatave

Më 22-23 tetor 2019, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të USAID-it realizoi trajnimin me temë: “Menaxhimi i gjykatave”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të udhëheqësve të divizioneve në gjykata në lëmin e menaxhimit.

Fillimisht u trajtua menaxhimi në përgjithësi dhe menaxhimi i gjykatës dhe prokurorisë, tiparet e një menaxheri të mirë, detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe tiparet menaxhuese dhe tendencat që duhet shmangur. Në vazhdim u trajtuan: Matja e angazhimit të punëtorëve, interpretimi i të dhënave për angazhimin e punëtorëve të gjykatës dhe kërkimi i pikave të ndritshme.

Gjatë trajnimit u potencua se me këtë trajnim synohet ngritja e kapaciteteve profesionale për pjesëmarrësit në sferën e menaxhimit i cili ndërthet organizimin dhe harmonizimin e resurseve për të arritur qëllimet e caktuara drejt sukseseve. Menaxhimi kërkon planifikim, organizim, udhëzime dhe monitorim.

Pas një shqyrtimi të gjithanshëm u ofruan përgjigje në çështjet: Si menaxhohet suksesshëm një gjykatë apo prokurori? Cilat

janë parimet standarde të menaxhimit të mirë? Dhe cilat janë sfidat dhe mangësitë aktuale të menaxhimit të gjykatës dhe prokurorisë?

Me theks të veçantë u potencua se organizimi i një analize është hapi i parë më i rëndësishëm drejtë reformimit. Vula e një sistemi drejtësie me performansë të lartë është vullneti politik dhe kapaciteti në performansë në baza të rregullta dhe të vazhdueshme, për të përfituar njohuri dhe depërtim në realitete të reja, mundësi dhe nevoja, dhe për të kthyer njohurinë dhe këtë depërtim në strategji efektive për përmirësim.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe nga praktika duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesi, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në menaxhimin efikas të gjykatave si dhe përmes detyrave dhe rasteve praktike.

Përfitues në këtë trajnim ishin: udhëheqësit e divizioneve të gjykatave.



## Takimi i Komisionit për Çështje Normative i Akademisë së Drejtësisë

Më 23 tetor 2019, në Akademinë e Drejtësisë u zhvillua takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative i Akademisë së Drejtësisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i vështirësive dhe problemeve praktike me rastin e zbatimit të Rregullores nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë si dhe adresimi i tyre përmes ndryshimit apo plotësimit të kësaj rregulloreje.

Me rastin e këtij takimi u shqyrtua rregullorja me theks të veçantë tek dispozitat kur flitet për angazhimin e trajnuesve në zbatim të programit trajnues, te trajnimi i trajnuesve, te mundësia për të drejtën e ankesës dhe çështje tjera me rëndësi për të cilat Komisioni Normativ i AD-së u dakordua në nxjerrje të rregullores së re meqë kjo rregullore ka pasur një herë ndryshim dhe plotësim të saj.



**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**